

Nga njëri ekstrem në ekstremin tjetër!



**Selman el-Aude apelon për
bashkimin e Selefive dhe Shijave
Rafidij në luftën kundër Çifutëve**

???!!!

© Selefî.org



Pejgamberi (ﷺ) ka thënë:



“Me të vërtetë, nga Umeti im do të shfaqen disa njerëz të cilët do t’i pushtojnë epshet ashtu sikurse pushtohet geni nga sëmundja e tërbimit. Asnjë venë e asnjë nyje nuk ka për të mbetur e veçse ato (epshet) kanë për t’i pushtuar.”¹



¹ **Hadith Sahih:** Transmetuar nga Ahmedi (4/102) dhe Ebu Davudi (n. 4957). Është saktësuar nga Imam el-Albani në kontrollin që i ka bërë Sunenit të Ibn Ebi ‘Asim (1/7).

“Ne duhet ta përdorim këtë krizë si një mjet për arritjen e Unitetit... Na duhet t’i lëmë mënjanë mosmarrëveshjet tona për këtë kohë... duhet të marrim përsipër përgjegjësinë për këto kriza, duke e ditur me besim të plotë se Allahu është i Drejtë në vendimet e Tij...”

Ky ishte apeli që lëshonte Selman el-Aude në programin e tij javor televiziv, të titulluar “*el-Hajat Kelimat*” (Korrik 2006) gjatë luftës që u zhvillua në Liban mes ushtrisë Çifute dhe luftëtarëve Rafidij të Hezbollahut. Po i njëjti mesazh u publikua madje edhe në faqen zyrtare të Selman Audes në internet. Të njëjtin apel e kishte dhënë madje edhe Jusuf Kardavi, i cili për më tepër e dënonte çdo tentativë e cila shkaktonte ndarje midis Sunitëve dhe Shijave.

Pra, kjo deklaratë përmban thirrje për solidaritet dhe unitet me Rafidat e Libanit. Sipas tij, Pasuesit e Sunetit në Liban duhet t’i bashkangjiten ushtrisë së Tagutit Hasan Nasrallah, liderit të Hezbollahut.² Dhe vërtet, muslimanët dolën rrugëve duke thirrur “Ne jemi Hezbollah!” dhe duke mbajtur në duar parrulla me surratin e këtij taguti. Pa mendoni pak! A është normale që një Musliman të mbajë në dorë parrulla me surratin e një

² Dijetari i madh, Shejkh Rabij’ Ibn Hadij el-medkhalij, Allahu e ruajt, ka thënë me këtë rast:

“Unë ju pyes: Ky flamur (i udhëheqjes në Xhihad) që është në Liban, a është ai një flamur që meriton të quhet flamur në Rrugë të Allahut, të quhet xhihad në Rrugë të Allahut, ndërkohë që ata (rafidat) i shpallin Sahabët qafira dhe e shtrembërojnë Kur'anin aq shumë sa që edhe vetë Çifutët nuk konkurojnë dot me ta. Ju nuk i keni lexuar ato çfarë shkruajnë Rafidat. Kushdo që lexon (shkrimet e tyre) do të shohë se ata janë më të këqinj në shtrembërimin e Fesë së Allahut se sa ç’mund të jenë Çifutët dhe Kristianët, Allahu ju bekoftë...”

Tani, Hizbullah po lufton që prej tri javësh, vetëm 8 janë vrarë nga radhët e tyre dhe rreth njëmijë nga popullata Libaneze janë vrarë dhe vendbanimet e tyre janë shkatërruar.

...Ne e duam Xhihadin, por Xhihadin e saktë.

...Ky është një xhihad i rrezikshëm, një xhihad Rafidi...

...Ne besojmë në Xhihadin më shumë sesa këta gënjeshtarë...

...Dhe qëkur na paska dalë ky Rafidi, ky Batini (Hasen Nasrallah) që të drejtojë këtë Umet?”

Lexojeni të plotë deklaratën e tij: <http://www.sahab.net/forums/showthread.php?t=337224>

njeriu që i bën Shirk Allahut duke adhuruar imamët e shijave, që beson se imamët e tij janë më të mirë se Pejgamberët dhe madje më të mirë se melaiket, që beson se imamët e tij e dinë gajbin (të fshehtën që s'e di askush tjetër përveç Allahut), që beson se Kur'ani është i ndryshuar, që beson se Sahabët janë qafira...???

Ndërsa në lidhje me konfliktin që po zhvillohet në Irak ndërmjet Muslimanëve Sunitë dhe Shijave, Selman el-Aude deklaronte:³

“Liderët Islamikë dhe njerëzit e tyre duhet të bashkohen. Grupet Muslimane duhet t'i harrojnë ndryshimet e vogla që ata kanë në besimet e tyre pasi një konflikt i brendshëm ndërmjet grupeve Islamike do të ishte vetëm në dobi të armikut.”

Ky pra është Selman el-Aude. Nëse deri dje ai ishte një nga imamët e kutbijinëve, sururive dhe tekfirsave anë e mbanë botës, sot, për fat të keq, Selmani u ka kthyer shpinën ithtarëve të tij të tekfirit dhe xhihadit dhe ka përqafuar ide më të moderuara. Ai e ka braktisur më në fund ekstremin e Khauarixhëve me në krye Bin Ladenin, Zauahirin, Zarkauin... dhe ka zgjedhur rrugën e pajtimit dhe mirëkuptimit ndërmjet sekteve. Më saktë, ai u hodh në ekstremin tjetër: në nëpërkëmbjen e Teuhidit dhe Akides së pastër Islame dhe bashkimin me sektet më të devijuara që kanë njohur ndonjëherë Muslimanët. E shohim Selmanin teksa organizon konferenca dhe takohet me sufi,⁴ kuburi, rafidi,⁵ sekularistë dhe bidatçij të tipeve të ndryshëm.

³ Publikuar nga ArabTimes (www.ArabTimesonline.com, Edicioni N. 12881, 13 Maj, 2007).

⁴ Shiko: <http://abo222.maktoobblog.com/?post=517297>

Në shkurt të 2007 Selman el-Aude mori pjesë në një takim të mbajtur në Kuvajt, ku ishin të pranishëm gjithashtu Aid el-Karni, Tarik es-Suvejdan dhe sufisti i zjarrtë, thirrësi për adhurimin e varreve, Ali el-Xhifri. Shiko:

<http://2007.familyinnovationconference.com/teachers/index.php>

<http://2007.familyinnovationconference.com/timetable/index.php>

Kurse mevludin e vitit 2006 Selmani e kremtoi në shtëpinë e klerikut të famshëm Sufi, Abullah Fadak, në Medine. Shiko:

<http://www.washingtonpost.com/wp-dyn/content/article/2006/05/01/AR2006050101380.html>

⁵ Shiko: <http://www.sahab.net/sahab/showthread.php?s=&threadid=294432>

<http://www.sahab.net/sahab/showthread.php?s=&threadid=294540>

<http://www.sahab.net/sahab/showthread.php?s=&threadid=294546>

Kurse këtu lexoni denoncimin që ka bërë një kutbi, ish-fanatik i Selman el-Audes:

<http://www.sahab.net/sahab/showthread.php?s=&threadid=294549>

Ai ka përqafuar tashmë metodologjinë e Hasen el-Benës duke i ftuar Muslimanët që t'i lënë mënjane mosmarrëveshjet që kanë ata me Shijat. Këto fjalë nuk ndryshojnë shumë nga ato që i kanë thënë baballarët mendimtarë të Selman el-Audes. Për shembull, Hasen el-Bena ka thënë (siç gjendet në librin *“Dhekerijati la Mudhekkira”* të Umer et-Tilimsanit, fq. 249-250): **“Dijeni se Sunitët dhe Shijat janë vëllezër. Ata i bashkon deklarata La ilahe il-lallah Muhameden-Rasul-lullah” dhe ky është themeli i Akijdes. Sunitët dhe Shijat janë të barabartë për sa i përket kësaj dhe të dyja palët janë të pastër. Kurse për sa i përket mosmarrëveshjeve që ata kanë me njëri-tjetrin, ato janë mosmarrëveshje për të cilat është e mundur që ata të bashkohen.”**

Dhe në librin e tij *“Fij Kafilet-il-Ikhuanul-Muslimijn”* Hasen el-Bena ka thënë: **“Ju e dini o vëllezër se nuk ka Imam në ditët e sotshme, se është e domosdoshme për ne që të harrojmë çdo gjë dhe të braktisim çdo gjë për të çliruar tokat Islame...”**

Ndërsa Sejjid Kutbi ka thënë në librin e tij *“Nahua Muxhtemi’ Islami”* (fq. 103): **“... dhe Islami nuk ndihet i qetë nga mosmarrëveshjet që ka njerëzimi në Akijde dhe Menhexh, më saktë, ai e konsideron këtë si diçka që nevojitet nga prirja natyrale dhe një qëllim nga Vullneti i Lartë...”**

Ky është arsyetimi dhe ideologjia e ndjekur për gati një shekull nga Ikhuhanul-Muslimin. Ky është menhexhi i aktivistëve plotikanë, një menhexh i zhveshur nga çdo argument fetar, i propaganduar nga mendjet më mediokre në rradhët e Muslimanëve. Ky është menhexhi i atyre që i kanë shkaktuar këtij Umeti kaq plagë e vuajtje me sloganet e tyre për harmoni dhe unitet mes medh’hebeve dhe tarikateve.

Shejkh ‘Abdul-‘Aziz bin Baz, Allahu e mëshiroftë, është pyetur:

“Duke u bazuar në dijen që keni ju rreth historisë së Rafidave (Shijave), Çfarë qëndrimi keni për sa i përket fillimit të bashkimit midis Ehli-Sunetit dhe atyre (Shijave)?”

Ai, Allahu e mëshiroftë, u përgjigj:

“Bashkimi i Ehli-Sunetit me Shijat është i pamundur për shkak të besimeve të ndryshme që kanë ata. Besimi i Ehli-Sunetit dhe Xhematit

(*Ehlu-Sunneh uel-Xhem'ah*) është që të njësohet Allahu i vetëm me adhurim dhe adhurimi të bëhet me singëritet vetëm për Allahun (ﷻ) dhe të mos i drejtohesh dikujt tjetër bashkë me Të, as ndonjë meleku që është i afërt (tek Allahu) e as ndonjë Pejgamberi që është dërguar. Dhe është Allahu Ai që i di çështjet e Gajbit.

Dhe nga besimi i Ehli-Sunetit është dashuria për Sahabët – Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata dhe Ai është i kënaqur me ta – dhe të besosh se ata janë krijesat më të mira të Allahut pas Pejgamberëve, dhe më i miri prej tyre është Ebu Bekr Sidiku, pastaj 'Umeri, pastaj 'Uthmani, pastaj 'Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata. Kurse Rafidat e kundërshtojnë këtë, prandaj nuk ka pajtim mes këtyre dy besimeve, ashtu sikurse nuk ka pajtim mes Çifutëve, të Krishterëve, idhujtarëve dhe Ehli-Sunetit. Kështu që, nuk ka afrim midis Rafidave dhe Ehli-Sunetit për shkak të besimeve të ndryshme që i sqaruar.”

Shejkhu, Allahu e mëshiroftë, u pyet përsëri:

“A është e mundur/e lejuar që të luftosh bashkë me ta (d.m.th. të luftosh përkrah Rafidave) kundër një ushtrie të huaj, siç janë për shembull Komunistët etj... ?”

Ai u përgjigj:

“Unë nuk e konsideroj atë si të mundur/të lejuar. Por Ehli-Suneti e kanë për detyrë që të jenë të bashkuar dhe një Umet i vetëm, një trup i vetëm dhe t'i ftojnë Rafidat që të kapen pas gjithçkaje që thotë Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit (ﷺ) me të Vërtetën.

Dhe nëse ata kapen pas tyre (pas Kur'anit dhe Sunetit), ata do të jenë vëllezërit tanë kurse ne do të bashkëpunojmë me ta. Për sa kohë që ata vazhdojnë në atë (rrugë) ku ndodhen, në urrejtjen e Sahabëve me përjashtim të një pakice prej tyre; në mallkimin e Sidikut (Ebu Bekrit) dhe 'Umerit dhe në adhurimin e familjes së Pejgamberit, ashtu siç bëjnë me 'Aliun (ﷺ), Fatimen, Hasenin dhe Husejnin (ﷺ) – dhe poashtu besimi i tyre se dymbëdhjetë Imamët janë të pagabueshëm dhe kanë dije rreth çështjeve të Gajbit; të gjitha këto janë nga pavërtetësitë më të mëdha dhe të gjitha këto bien në kundërshtim me atë që ndjekin Ehli-Suneti dhe Xhemati (*Ehlu-Sunneh uel-Xhema'ah*).”⁶

⁶ *Mexhm'u Fetava ue Mekalat*, Vëllimi 5.

Shejkhul-Islam Ibn Tejmije, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Nifaku dhe pabesia, mosbesimi që kanë Rafidat është më i madh se sa ç’mund të jetë tek të gjitha sektet apo grupet e tjera. Madje është e pamundur që ndonjëri prej tyre të mos ketë ndonjë aspekt të nifakut. Ngaqë me të vërtetë baza e nifakut në gënjeshtëri, është që njeriu të thotë me gjuhën e tij atë që nuk e ka në zemrën e tij, ashtu siç na ka njoftuar Allahu për Munafikët. Rafidat e marrin këtë gjë si themelin e fesë së tyre dhe e quajnë *Takije* dhe e lidhin me prijësit e Ehlul-Bejtit, ata të cilët i ka pastruar Allahu nga një gjë e tillë.”⁷

Dijetar i madh, *Sidik Hasen Khan*, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Dhe ne i kemi parë Rafidat e Indisë, ata të cilët i quajnë vetet e tyre el-Imamije dhe Shija; ata besojnë duke i shpallur Sahabët qafira, i shajnë ata haptazi në librat e tyre dhe i mallkojnë me gjuhët e tyre. Poashtu, (ata janë të zhytur në verbëri totale) në Indi dhe në vende të tjera. Me të vërtetë ata janë Keramitë⁸ në origjinën e tyre.

Dhe kur të vërtetohet plotësisht nga Kur'ani dhe Hadithi se me të vërtetë ata janë qafira, atëherë është obligim që atyre t’u jepet gjykimi që u jepet qafirave në të gjitha çështjet dhe vendimet e Fesë; lidhur me (braktisjen) e martesës me ata, (braktisjen e) Xhihadit përkrah tyre, refuzimin e medh’hebit të tyre, refuzimin haptazi të veprimeve të tyre dhe të besuarit se ata janë në diçka tjetër në vend të Islamit; dhe sa i përket realitetit të tyre, ata janë më të fëlliqtët nga të gjitha sektet e botës.”⁹

Ne i lutemi Allahut të Lartësuar që të na bëj ta shohim të Vërtetën si të Vërtetë dhe të Pavërtetën si të Pavërtetë dhe të na udhëzojë në Rrugën e të Parëve tanë të Mirë (*es-Selefus-Salih*).

*“Dhe çdo e mirë është në pasimin e Selefëve (të Parëve),
kurse çdo e keqe është në pasimin e Khalefëve (të Mëvonshmëve)!”*

⁷ *Minhaxhus-Sunneh*, 2/46.

⁸ **Keramitët** janë një sekt i hershëm të cilët u përpoqën që ta shkatërronin Islamin nga përbrenda duke rrëzuar kuptimin e Kur'anit dhe Sunetit dhe duke sjellë kuptime të pabaza.

⁹ *Ed-Dijnul-Khaliss*, 3/408-409.